

Ligjërata 6

INFLACIONI

⇒ Në këtë ligjëratë do të njiheni me:

→ *Kuptimin e inflacionit*

→ *Mënyrat e matjes së inflacionit*

→ *Llojet e inflacionit*

→ *Kostot (pasojat) e inflacionit*

KUPTIMI I INFLACIONIT

- ➔ **Inflacioni: sëmundje ekonomike**
- ➔ **Problemi i inflacionit - programet stabilizuese makroekonomike**
- ➔ **Bashkë me normën e papunësisë, norma e inflacionit shërben për të identifikuar trendin e ekonomisë vendore**
- ➔ **Sjellja e inflacionit përgjatë cikleve të biznesit**
- ➔ **Problem shqetësues për ndërmarrjet dhe konsumatorët**
 - ➔ **Bie fuqia blerëse e parasë**

MATJA E INFLACIONIT

- ⇒ **INFLACIONI: ngritje e vazhdueshme e çmimeve**
 - ⇒ Deflacioni: rënja e çmimeve (inflacion negativ)
 - ⇒ Desinflacioni: niveli i çmimeve bie por mbetet mbi nivelin e çmimeve në periudhën bazë

⇒ Si llogaritet inflacioni?

$$\text{Norma e Inflacionit (t)} = \frac{\text{Niveli i çmimeve (t)} - \text{Niveli i çmimeve (t-1)}}{\text{Niveli i çmimeve (t-1)}} \times 100$$

MATJA E INFLACIONIT

INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMATORIT (CPI)

- ➔ Indeksi më i përdorur për matjen e inflacionit
- ➔ Mat koston e një shporte mallrash dhe shërbimesh që konsumon një familje tipike për një periudhtë caktuar kohe:
 - ➔ Familje tipike = familja që më së miri i prezenton karakteristikat e popullacionit (mostra)
- ➔ Maten peshat specifike të secilit mall (pjesëmarrja e shpenzimeve të secilit mall në shpenzimet e përgjithshme të familjes)

...MATJA E INFLACIONIT PËRMES CPI: SHEMBULL

Në vitin 2004 konsumi i një familje ishte:

Ushqim	20%
Strehim	50%
Kujdes mjekësor	30%

Nëse viti 2004 merret si vit bazë atëherë:

$$\text{CPI}_{2004} = (0.2 \cdot 100) + (0.5 \cdot 100) + (0.3 \cdot 100) = 100$$

Në vitin 2005, çmimet rriten me sa vijon:

Ushqim	2%
Strehim	6%
Kujdes mjekësor	10%

Atëherë: $\text{CPI}_{2005} = (0.2 \cdot 102) + (0.5 \cdot 106) + (0.3 \cdot 110) = 106.4$

Norma e inflacionit:

$$i_{2005} = \frac{\text{CPI}_{2005} - \text{CPI}_{2004}}{\text{CPI}_{2004}}$$

atëherë

$$i_{2005} = \frac{(106.4 - 100)}{100} = 6.4\%$$

MATJA E INFLACIONIT

CPI ne Kosove bazuar ne te dhenate ESK

(materiali ne pdf)

MATJA E INFLACIONIT

INDEKSI I ÇMIMEVE TË PRODHUESIT (PPI)

- ⇒ Mat nivelin e çmimeve të shitjes me shumicë
- ⇒ Në parim matet njësoj sikur CPI
- ⇒ Tregues më i mirë se CPI
- ⇒ Merren në konsiderim shumë më tepër mallra

DEFLATORI I GNP

- ⇒ I aplikueshëm vetëm për rritje të vogël të çmimeve
- ⇒ Më i përshtatshëm se CPI dhe PPI pasi merr në konsiderim të gjitha mallrat dhe shërbimet

$$\text{Deflatori i GNP} = \frac{\text{GNP nominal}}{\text{GNP real}} \times 100$$

LLOJET E INFLACIONIT

Në përgjithësi në teorinë ekonomike inflacioni mund të klasifikohet në tri kategori kryesore:

➔ **INFLACIONI I MODERUAR**

➔ **INFLACIONI GALOPAN**

➔ **HIPERINFLACIONI**

Njohja e llojeve të inflacionit ndihmon në identifikimin e masava/politikave për luftimin e inflacionit

...LLOJET E INFLACIONIT

INFLACIONI I MODERUAR

- ➔ Çmimet rriten ngadalë
- ➔ Norma e inflacionit njëshifrore
- ➔ Njerëzit ende kanë besim në para:
 - ➔ Ata nuk e blejnë pasuri reale
 - ➔ Pra nuk ndryshon portfolio e pasurisë
- ➔ Njerëzit janë në gjendje të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale
- ➔ Sistemi monetar funksionon mirë
- ➔ Lidhja me objektivën makroekonomike: qëndrueshmëri e çmimeve

...LLOJET E INFLACIONIT

INFLACIONI GALOPAN

- ➔ Bie besimi tek paraja
- ➔ Rritje dyshifrore (e më shumë) e çmimeve
- ➔ Përdoren valutat e huaja për indeksim të kontratave
- ➔ Norma reale e interesit është negative
- ➔ Njerëzit i ikin mbajtjes së parave mbi një limit të domosdoshëm
- ➔ Njerëzit priren të grumbullojnë mallra ose blejnë patundshmëri
- ➔ Huadhënësit nuk japin kredi me normë të ulët të interesit
- ➔ Tregu financiar nuk funksionon

...LLOJET E INFLACIONIT

HIPERINFLACIONI

- ⇒ Shkatërrues për ekonominë
- ⇒ Çmimet rriten shumë herë brenda një muaji
- ⇒ Paraqitet në raste të rralla (psh. periudha të luftrave)
- ⇒ Shpejtësia e qarkullimit të parasë rritet (rriten transaksionet)
- ⇒ Çmimet relative (përfshirë edhe pagën) bëhen të paqëndrueshme

Disa shembuj të hiperinflacionit:

- Gjermani: 1922-1923 (indeksi i çmimeve u rritë nga 1 në 10.000.000.000%)
- Bolivi: 1985 (indeksi i çmimeve u rritë nga 1 në 12.000%)
- Ish Jugosllavia: 1993, etj.

KOSTOT (PASOJAT) E INFLACIONIT

➔ Gjatë periudhës inflacionite paraqiten humbësit dhe fituesit

➔ Ata nuk mund të identifikohen lehtë

➔ Pasi jo të gjitha çmimet rriten njësoj:

➔ Ndodhin ndryshime relative të çmimeve

➔ Prandaj, efektet/kostot e inflacionit konsistojnë në:

- Rishpërndarja e pasurisë (në mes klasave/shtresave të popullsisë)
- Alokimi joefiçient i resurseve dhe burimeve të prodhimit

KOSTOT (PASOJAT) E INFLACIONIT

- ➔ **Megjithatë kostot varen nga karekteri i inflacionit:**
 - Inflacioni i parashikuar (nuk ka humbës – norma e inflacionit mund të parashikohet dhe pershtaten cmimet dhe kontratat)
 - Inflacioni i pa-parashikuar (ka humbës – norma e inflacionit nuk mund të parashikohet)
- ➔ **Inflacioni ka edhe kosto tjera edhe kur eshte i parashikueshem:**
 - ➔ **Në një vend që ka inflacioni për një kohë të gjatë ndryshon kursi i këmbimit:**
 - ➔ **Bie vlera e valutës së vendit e shprehur në valuta të huaja**
 - ➔ **Të huajt nuk mbajnë valutën e këtij vendi**
 - ➔ **Kjo ka efekte në tregtinë ndërkombëtare**

...KOSTOT E INFLACIONIT

RISHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE PËR SHKAK TË INFLACIONIT

Shembull për diskutim: Nuk ka inflacion:

- Konsumatori merr kredi 5000 € me kamatë 10% vjetore
- Pas një viti ai paguan interes: $5000 \times 10\% = 500\text{€}$
- Si dhe paguan borxhin prej 5000
- Gjithsej: 5000 (borgji) + 500 (interesi) = 5500
- Banka fiton 500
- Konsumatori heq dore nga konsumi i tij i ardhshëm për të paguar interesin

...KOSTOT E INFLACIONIT

RISHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE PËR SHKAK TË INFLACIONIT

Shembull për diskutim: Ndodh inflacion por i parashikuar

- Supozojmë se inflacioni vjetor është 10%
- Në fund të vitit konsumatori paguan 5,500 € (borxhi + interesi)
- Por vlera e mallrave që mund të blehen me 5,500 € në fund të vitit baraz me vlerën e mallrave që janë blerë në fillim të vitit
- Kështu, banka dhe konsumatori pajtohen që norma e interesit t'i shtohet edhe norma e inflacionit
 - $10\% \text{ interes} + 10\% \text{ inflacion} = 20\%$
 - $20\% \times 5,000 \text{ € borxhi} = 6,000 \text{ €}$
- Nëse inflacioni është i parashikuar atëherë nuk ka humbës

...KOSTOT E INFLACIONIT

RISHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE PËR SHKAK TË INFLACIONIT

Shembull për diskutim: Ndodh inflacion por i pa-parashikuar

- Supozojmë se inflacioni vjetor është 10%
- Në fund të vitit konsumatori paguan 5,500 € (borxhi + interesi)
- Por vlera e mallrave që mund të blehen me 5,500 € në fund të vitit baraz me vlerën e mallrave që janë blerë në fillim të vitit
- Nëse banka dhe konsumatori nuk janë pajtuar paraprakisht:
 - **KA HUMBES**
 - konsumatori paguan 5500 që është baraz me 5000 shprehur në mallra dhe shërbime
 - Banka humb 10% interes
 - Konsumatori fiton
- **RISHPËRNDARJA PASURIA**

...KOSTOT E INFLACIONIT

ALOKIMI JOEFICIENT I RESURSEVE

- ➔ Çmimet shtrembërohen
- ➔ Informatat shtrembërohen
- ➔ Prodhuesit nuk mund të marrin vendime të drejta për investime
→ alokimi i resurseve në mënyrë të gabuar
- ➔ Kur inflacioni është i parashikueshëm efekti është më i vogël,
por efektet e inflacionit nuk mund të shmangen plotësisht
- ➔ Përdorimi i indeksimit: mbrojtja e interesave të grupeve të caktuara
 - ➔ Indeksi i bursave, pagesave për të papunet etj.
 - ➔ Kështu nëse inflacioni=10%, ato rriten me 10%

...KOSTOT E INFLACIONIT

Përmbledhje e kostos së inflacionit (tabela 18.1):

	Inflacioni i Balancuar	Inflacioni i Pabalancuar
Inflacion i pritshëm	Nuk ka kosto	Humbje në efikasitet
Inflacion jo i pritshëm	Të ardhurat dhe pasuria rishpërndahen	Humbje në efikasitet dhe rishpërndarje

Shënim:
Inflacioni quhet i balancuar kur rritja e çmimeve është me të njëjtën përqindje për të gjitha mallrat dhe shërbimet. Përndryshe inflacioni konsiderohet i pabalancuar

DETYRË

- ➔ Analizoni inflacionin ne Kosove prej Majit 2002 deri ne Shkurt 2010
 - ➔ Cili eshte trendi i inflacionit?
 - ➔ Ne baze te analizes se ketij trendi a mund te percaktoni ndonje cikel biznesi gjate kesaj periudhe (te keni parasysh sjelljen e inflacionit gjate fazave te ndryshme te cikleve te biznesit)
 - ➔ (kjo eshte edhe teme per seminar)
- ➔ Pergaditni “Pyetjet per diskutim” ne faqe 337.